



PËRMIRËSIMI I TRANSPARENCËS DHE
SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOMUNAT ME
SHUMICË TË KOMUNITETIT SERB



Funded by: BUREAU OF
INTERNATIONAL NARCOTICS AND
LAW ENFORCEMENT AFFAIRS
KOSOVO

Objektivi kryesor i projektit është të përmirësojë cilësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes përmes veprimeve që synojnë krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm që do t'u mundësojnë pjesëmarrësve të projektit të monitorojnë për nga afër dhe në mënyrë efikase punën e qeverive lokale dhe gjykatave. Programi do të bëjë përpjekje të përmirësojë administrimin e drejtësisë në pjesën veriore të Kosovës dhe zonat me shumicë serbe në rajone të tjera të Kosovës duke mbështetur institucionet gjyqësore dhe duke lehtësuar përfshirjen e avokatëve të rinj nga komunitetet jo-shumicë në praktikën e avokaturës.

Projekti do të ndahet në dy komponentë; njëra që merret me pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe tjetra me mbështetjen e institucioneve gjyqësore, dhe secili komponent drejtohet nga një organizatë me kompetenca specifike në ato fusha.

Objektivi specifikë në kuadër të kompetencës 1:

Objektivi specifik 1: Rritja e kapacitetit për të luftuar korrupsionin në nivelin lokal duke forcuar OSHC-të dhe rrijetëzimin e tyre në Këshillin Lokal Antikorrupsion, i cili do të përfshijë gjithashtu përfaqësues të qeverive lokale dhe mediave

Objektivi specifik 2: Kontribimi në krijimin e mekanizmave lokalë për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal. Kjo do të arrihet përmes krijimit të një Këshilli Lokal Kundër Korrupsionit për të siguruar transparencën në procesin e vendimmarrjes që do të veprojnë si një mbrojtje kundër korrupsionit. Kjo do të çojë në transparencë më të madhe dhe në nivelin lokal do të kontribuojë në zvogëlimin e sjelljes korruptive të institucioneve të ndryshme publike në komuna me shumicë të popullsisë serbe.

Objektivi specifik 3: Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë dhe mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal. Arritja e këtij qëllimi ndërmerr një gamë më të gjerë të aktiviteteve të ndërgjegjësimit, duke përfshirë përfaqësuesit e qeverisë lokale në komunat me shumicë serbe të Kosovës, qytetarët dhe OSHC-të mbi mekanizmat e përshtatur për të forcuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Objektivat specifike në kuadër të komponentës 2:

Objektivi specifik 1: Rritja e efikasitetit të institucioneve gjyqësore të integruara në veri të Kosovës dhe në zona të tjera të Kosovës të banuara me serbë të Kosovës.

Objektivi specifik 2: Kontribuimi në përfshirjen më të mirë të avokatëve të rinj nga komuniteti jo-shumicë në Kosovë në praktikën e avokaturës.

Objektivi specifik 3: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për funksionimin e gjyqësorit të integruar në pjesën veriore të Kosovës dhe zonat me shumicë serbe të Kosovës dhe të drejtat e qytetarëve para këtyre institucioneve.

Përmbledhje e aktiviteteve që do të ndërmerren në kuadër të projektit:

Komponenta 1: AKTIV

O1.A1: Trajnimi për OSHC-të, qeveritë lokale dhe mediat

O1.A2: Krijimi i një Këshilli Lokal Anti-korrupsion.

O1.A3: Konferencë publike mbi anti-korrupsionin dhe transparencën në nivelin lokal

O1.A4: Zbatimi i "Kërkimit dhe analizës themelore të perceptimit publik të transparencës dhe korrupsionit në nivelin lokal"

O1.A5: Kampanja për ngritjen e vetëdijes.

Komponenta 2: ACDC

O2.A1: Fillimi i ngjarjes.

O2.A2: Trajnimi për gjyqtarë dhe zyrtarë ligjorë.

O2.A3: Trajnim për avokatët e rinj: Minimum njëzet (20) avokatë të rinj nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë do të trajnohen në aftësi praktike juridike.

O2.A4: Simulimi i gjykimit: Pas programit të trajnimit, do të organizohet një simulim i gjykimit për të siguruar mundësi për avokatët e rinj për të marrë pjesë në një procedurë gjyqësore të simuluar.

O2.A5: Skema e praktikës: Të paktën njëzet (20) avokatë të rinj do të përfundojnë një praktikë tre-mujore në Zyret e avokaturës në veri të Kosovës.

O2.A6: Aktivitetet e Ndërgjegjësimit Publik: AKTIV dhe ACDC do të organizojnë një fushatë publike mbi funksionimin e gjyqësorit të integruar në zonat me shumicë serbe përmes një sërë aktiviteteve publike dhe diskutimesh përmes një fushate të vetme mediatike

Rezultatet e pritura:

ER 1: Njëzet (20) aktivistë të shoqërisë civile dhe medias janë trajnuar dhe pajisur me njohuri për luftimin e korrupsionit dhe përmirësimin e transparencës në nivelin lokal.

ER 2: Këshilli lokal anti-korrupsion është themeluar në komunat e Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Zubin Potokut, Leposaviqit, Graçanicës dhe Shtërpçës dhe ka filluar pesë (5) iniciativa specifike.

ER 3: Hulumtimi themelor është kryer me të paktën 300 të anketuar dhe të paktën 20 intervista të kryera me përfaqësues të komuniteteve, OSHC-ve dhe mediave.

ER 4: Ndërgjegjësimi i publikut i ngritur përmes aktiviteteve publike, duke përfshirë: katër (4) dëgjime publike dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e broshurave arsimore në komunat me shumicë serbe.

ER 5: Të paktën njëzet (20) gjyqtarë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë u trajnuan përmes trajnimeve të avancuara juridike dhe seminareve të mbajtura nga trajnerë ekspertë nga Dhoma e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

ER 6: Të paktën njëzet (20) avokatë të rinj nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë janë trajnuar në aftësi praktike juridike.

ER 7: Ndërgjegjësimi i publikut për funksionimin e një gjyqësori të integruar në zonat me shumicë serbe është rritur përmes një serie paraqitjesh dhe diskutimesh publike dhe një fushate të fortë mediatike.

Projekti do të mbulojë katër komuna me shumicë serbe në veri të Kosovës, si dhe dy komuna me shumicë serbe në jug të lumit Ibër:

- Mitrovica veriore;
- Zveçani;
- Leposaviqi
- Zubin Potok;
- Shtërpce;
- Graçanica

Grupet e synuara:

Ky projekt do të ketë grupet themelore të synuara si më poshtë:

- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Përfaqësuesit e mediave (lokale);
- Përfaqësuesit e institucioneve në nivelin qendror dhe lokal;
- Publiku i gjerë.